

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"IVISION.AL" SH.P.K.

KREUI

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "IVISION.AL" SH.P.K. themelohet në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligjit nr. 9723 dt.03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Sot, më 10 Shkurt 2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "IVISION.AL" SH.P.K.

Shoqëria themelohet nga 2 (Dy) ortake.

Z. Gentjan Pjetërgjokaj lindur në Shkodër, më 08.08.1999, me banim në Tiranë, Rr: Anri Buasen” me kartë identiteti Nr. J90808066L

Dhe

Znj. Anisa Muçollari , lindur në Korçe, më 08.02.1997, me banim në Tirane, Rr. “Maliq Muço me kartë identiteti Nr. J75208021C

Neni 2

Emërtimi i shoqërisë është "IVISION.AL" SH.P.K.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat te pacaktuar.

Neni 4

Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti krijohet me mjete private të themeluesve te saj

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "IVISION.AL" SH.P.K.

Ne perputhje me krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacion shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesve dhe te punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Neni 6

Shoqeria "IVISION.AL" SH.p.K. eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit ne organet perkatese. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara nō dokumentat e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

Neni7

Shoqeria do te kryeje aktivitet me objekt:

-Shoqeria do te ushtrojne veprimtari Telemarketing-Call Center, perbrenda (inbound) dhe jashte (outbound), brenda vendit dhe nderkombetare.

-Sherbime telemarketingu on line apo jo, te çdo forme dhe tipi, direkt apo indirekt.

- Marketing sherbimesh apo produktesh duke mos u limituar vetem ne to.

-Promocione.

-Trajnime profesionale ne te gjitha fushat e mesiperme duke mos u limituar vetem ne to.

Shoqeria kryen çdo aktivitet ne raport me objektin e vprimtarise apo te afte per ta favorizuar ate. Ajo zbaton standartet me te mira te etikes profesionale. Shoqeria per te realizuar objektin e saj mund te perdore me hua ose shperblim toke, te marre me qira, te blej dhe te administroj, magazina, automjete, pajisje, makineri, per kete lloj aktiviteti, etj. Çdo aktivitet qe do kryhet ne perputhje me parashikimet ligjore, rregullatore, dhe adminsitrative qe jane miratuar dhe do miratohen nga organet kompetente shteterore.

Neni 8

Selia e shoqerise "IVISION.AL" sh.p.k : Rruga :” "Muhamet Gjolllesha", godine polifunkionale (Tirana Ring Center) shkalla 2, kati i 9, Ap.Nr.21. Tirane

Neni 9

Shoqeria ushtron veprimtarine e vete te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele dege, filiale dhe

zyra te saja te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

Neni 10

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Neni 11

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera e per te drejta te tjera pronesie.

Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tek kapitali themeltar.

Neni 12

TE drejta kryesore te ortakeve jane:

- 1.Pjesemarrja ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin e vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
- 2.Pjesemarrja ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- 3.Pjesemarrja ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- 4.Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara te shoqerise si bilancet, Ilogarite ekonomike etj.
- 5.Te beje propozime dhe t'i paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- 6.Te emeroje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Neni 13

Detyrimet e ortakeve jane:

- 1.Pjesemarrje ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve qe krijon ai.
- 2.T'i jape shoqerise informacionet e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj
- 3.Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

KREU II

Kapitali i Regjistruar

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

Neni 15

15.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte i barabarte me 1,210,000 Leke (nje milion e dyqind e dhjete mije) dhe eshte i ndare ne 2 (dy) kuota.

Kapitali i shoqerise eshte teresisht i nenshkruar dhe i derdhur nga ortaket sipas kontributit te meposhtem.

15.2

Z. Gentjan Pjetërgjokaj lindur në Shkoder, më 08.08.1999, me banim në Tiranë, me banim ne me kartë identiteti Nr. J90808066L, eshte titullar I kuotave te pjesemarrjes me vlere 605,000 Leke (gjashteqind e pese mije), ekuivalent i 50% te kapitalit te shoqerise;

dhe

Znj. Anisa Muçollari , lindur në Korçe, më 08.02.1997, me banim në Tirane, Rr. “Maliq Muço me kartë identiteti Nr. J75208021C eshte titullare e kuotave te pjesemarrjes me vlere 605,000 Leke (gjashteqind e pese mije) ekuivalent i 50% te kapitalit te shoqerise;

Neni 16

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj, ortaket e shoqerise kane te drejten per nenshkrimin e rritjes se kuotes ne menyre proporcionale te mbajtur nga cdo ortak ne shoqeri ne ate date.

Neni 17

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve. Transferimi duhet te vertetohet me akt noterial.

Neni 18

Shoqeria ne emer te vete eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci dhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Neni 19

Shoqeria krijon fonde rezerve ose fonde te tjera te veganta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise saj mbulohen nga fondet rezerve, fondet e tjera ose nga shumat themeltare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakut te vetom, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

Viti Financiar, Llogarite Vjetore, Ndarja e Fitimit

Neni 20

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ne ditën e regjistrimit shoqerise dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

Neni 21

Pasqyrat Financiare vjetore te shoqerise deklarohen brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.

Neni 22

Ortaku e perballon vete humbjen e veprimtarise se shoqerise ne te ardhmen.

Neni 23

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e veganta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortaku i shoqerise. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 24

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, pas zbritjes se te gjitha detyrimeve si dhe fondet e lena per rezerve per nxitje ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj. e perfitojne 100% ortakët e shoqerise.

KREU IV

ADMINISTRIMI

Neni 25

Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja mblidhet në rastet e përcaktuara nga Ligji nr.9901 , nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statudit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për te mbrojtur interesat e shoqërisë sipas kërkesave të nenit 82, pika 2 e ligjit nr. 9901. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

1. Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative me vendim ortakë në kuadër të emërimit:

- a) Nga të dy administratorët dhe, ose nga një administrator i vetëm.
- b) Nga një këshill administrativ i përberë nga 2 deri në 5 anëtarë sipas numrit të përcaktuar të ortakëve në momentin e emërimit të administratorëve dhe/ose të administratori të vetëm.
- c) Nëse do të emërohen 2 apo më shumë administratorë, ortakët do të përcaktojnë kompetencat në kuadër të emërimit.
- d) Administratorët mund të jenë edhe ortakë
- e) Administratorëve u aplikohet ndalimi i konkurrencës sipas ligjit.

2. Asambleja emëron administratorin për një periudhë 5 (pese) vjeçare sipas parashikimeve të shkronjës 'c' të pikës 1 të nenit 81 dhe të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Emërimi do të jetë individual dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja .

3. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 Ligjit.

4.Z. Gentjan Pjetërgjokaj dhe Znj.Anisa Muçollari ortakët e vetëm të kompanisë, caktohen si dy administratorë të shoqërisë me të drejtë të barabarta veprimi së bashku ose/dhe secili me vetë.

Neni 26

Kompetencat e Administratorit janë:

1. Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblese, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar.
3. Miratimi i akteve normative përcaktojnë raportet e gjithë të shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë
5. Krijimi i organeve të tjera domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
6. Propozimi në mbledhjet e asamblese për krijimin e njesive, strukturave, filialeve, degëve dhe përfaqësive në qytetet e tjera të vendit apo jashtë shtetit.
7. Përzgjedhja e Ekspertit Kontabel dhe anëtarëve të komisionit likuidimit dhe paraqitja e propozimeve për miratim në asamble.
8. Administratori vepron në çdo moment në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti i interesit, administratori i përfshirë do të informojë menjëherë ortakët, dhe do të shmangë përmbushjen e çdo akti apo veprimi në lidhje me konfliktin e interesit deri në marrjen e instruksioneve nga asambleja e përgjithshme.

KREU V

Prishja dhe Njoftimet

Neni 27

Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një Auditues Ligjor për tre vite financiare me mundësi rizgjedhjeje. Ai caktohet nga ortakët e shoqërisë. Shkarkimi i audituesit ligjor vendoset në të njëjtat kushte si emerimi, ose kur behet e pamundur kryerja e detyrave.

Neni 28

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe Vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këto qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë menyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

KREU VI

Dispozita të fundit

Neni 29

Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të mbahen në një libër të veçantë që mbahet në selinë e shoqëfisë.

Neni 30

Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2(dy) kopje.

ORTAKËT E SHOQËRISË

"IVISION.AL " SH.P.K

Gentjan Pjetërgjokaj

Z. Gentjan Pjetërgjokaj



Anisa Muçollari

Znj. Anisa Muçollari

